

# AKT THEMELIMI

## I

### SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### " Gean 2016 " SH.P.K

Sot, më datë 02.11.2022,

**Andi Zami**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 21.09.1982, lindur në Shkoder, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 038403006 dhe Nr. Personal I20921083P dhe që zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

#### NENI 1

##### Themelimi

Emri i shoqërisë është **"Gean 2016" Sh.P.K.** Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri **"Gean 2016" Sh.P.K.**

#### NENI 2

##### Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e: Shit-blerjes se automjeteve, makinave me qera dhe import dhe eksport.

#### NENI 3

##### Emri dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin **" Gean 2016 " Sh.p.k** dhe kompania do ketë vulën e saj.

#### NENI 4

##### Objekti i veprimtarisë

Objektivi i shoqërisë do jetë: Shit-blerjes se automjeteve, makinave me qera dhe import dhe eksport.

#### NENI 5

##### Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Shkodres me adresë: Shkodër, Lagjia "Perash", Rruga "Tepe", Zona kadastrale 8594 dhe numer pasurie 7/284.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

#### NENI 6

##### Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën **1,000,000** (Nje milion) lekë, i ndarë në 1 kuote.



Ortaku themelues të Shoqërisë Tregtare me emrin **“Gean 2016” Sh.P.K** zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

**Andi Zami**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 21.09.1982, lindur në Shkoder, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 038403006 dhe Nr. Personal *I20921083P dhe që* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit dhe vlere totali te kapitalin 1,000,000 (nje milion) leke.

Kapitali themeltar do te shlyhet plotësisht në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë dhe hapjen e niptit dhe llogarise bankare. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

#### **NENI 7**

##### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

#### **NENI 8**

##### **Administratori**

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

#### **NENI 9**

##### **Caktimi i Administratorit**

Administrator caktohet për një afat 5-vjeçar, **Andi Zami**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 21.09.1982, lindur në Shkoder, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 038403006 dhe Nr. Personal *I20921083P*.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 10**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 11**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 12**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 13**




Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

#### **NENI 14**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

#### **ORTAKËT THEMELUES**

**Andi Zami**

A stylized, handwritten signature in blue ink, consisting of several loops and a long tail stroke.

ANDI ZAMI